

NUMRI I I-rë TETOR 2007

PËR ZBULUESIT  
DHE KURESHTRARËT  
E RINJ

# NATIONAL GEOGRAPHIC Junior

FALAS!



Zbulo gjithçka mbi  
tigrat, peshkaqenët  
apo pinguinët.  
Mëso si dhe ku jetojnë ata.

Nisemi për  
**SAFARI!**

NATIONAL  
GEOGRAPHIC

300 lek  
Shtëpia Botuese  
"Jeto Media Company", Tiranë  
Shtëpia Botuese "Klett", Beograd


Rrëqebulli ose

# tigri i Evropës

A e dini se në pyjet e Shqipërisë jeton një lloj mace e egër e mrekullueshme që quhet rrëqebull!

Rrëqebulli është një nga kafshët më interesante dhe më të bukura të vendit tonë. Duket si një mace dhe bën pjesë në familjen e tyre, por është shumë më i madhi se kafshët që ne mbajmë në shtëpitë tona. Kjo kafshë është aq e fshehtë sa edhe vetë gjahtarët e shohin shumë rrallë. Por është kjo fshehtësi, ky mister, që e bën atë më magjik! Mbretëror, ai sundon pyllin me shkathtesinë e tij.

Rrëqebulli është një kafshë që ka shumë pretendime ndaj mjedisit ku jeton. Por vendi që preferon më shumë është reliivi malor me bimësi pjore. Është një kafshë që ndeshet rrallë, madje konsiderohet një specie në zhdukje.



Rrëqebulli bën pjesë në familjen e maceve dhe është mishngrënësi më i madh në Evropë pas ariut dhe ujkut. Për këtë ai është quajtur vëllai i vogël i ariut dhe vëllai i madh i ujkut, sepse një rrëqebull është aq i shkathët sa mund ta mbysë një ujk shumë lehtë. Ai është një kafshë e bukur dhe e shpejtë si rrufeja. Pak kush ka dëgjuar të flitet për rrëqebullin. Janë edhe më të rrallë ata që mund të krenohen se kanë parë një të tillë. Ai endet madhështor nëpër pyjet e maleve të larta të Shqipërisë i rrethuar nga mistere dhe legjenda.

E nëse historia jonë ju ngacmoi ndopak kuriozitetin, mund t'ju tregojmë se ku ta shikon këtë kafshë të veçantë. Mund ta kundroni të balsamosur në Muzeun e Kafshëve në Tiranë. Por mund të studioni dhe lëvizjet e saj të shkathta në kafaz, tek "Sofra e Ariut" në Tiranë, ose tek "Gjahtari", një tjetër lokal buzë Shkumbinit, që përvëç rrëqebullit, ka edhe shumë kafshë e shpendë të tjerë të mahnitshëm.

## Trupi i tij dhe mjedisi ku jeton

Trupi i tij shkon nga 80 deri 130 cm gjatësi, i lartë rreth 65 cm, dhe peshon 12 deri në 35 kilogramë. Rrëqebullit i pëlqen më shumë të rrijë vetëm dhe takohet rrallë me rrëqebuj të tjerë. I reziston shumë të ftohit dhe lagështirës, kjo është arsyaja që në vendin tonë haset më shumë në zonën e Alpeve, Pukë, Lurë, Martanesh e Librazhd. Ai dallohet nga gjëzofia që në stinën e verës ka ngjyrë të verdhë të çelur, ndërsa në dimër merr ngjyrë të kuqërreme. Njolla ngjyrë kafe mbi shpinë dhe në gushë e bëjnë gjëzofin e rrëqebullit shumë karakteristik. Ka veshë të gjatë dhe bisht të shkurtër me majë të zezë, këmbë shumë të fuqishme me thonj të mprehtë. Sytë janë të mëdhenj dhe bebet e tyre me ngjyrë të gjelbërt në të verdhë shkëlqejnë në errësirë. Brenda një nate rrëqebulli mund të vrapojë deri në 45 km.



### E dini se?

Rrëqebulli nuk ka armiq.

Vellezëit e tij janë ariu dhe ujku.

Një rrëqebull jeton deri në 17 vjet.

Thuhet që rrëqebulli është aq i fuqishëm saqë mund të sfidojë edhe një ujk.

Është një kafshë në zhdukje dhe në të gjithë botën ka vetëm 100 rrëqebuj.

Nga këta 100 rrëqebuj në të gjithë botën, 25 prej tyre jetojnë në pyjet shqiptare.

### Me çfarë ushqehet?

Ushqehet me lepuj, ketra, minj të pyllit, kaproj, derra të egër, por edhe mish shpendësh.